



# - SALSTAT -

NR. 2

# SALSTAT

Statistika të Forta Vendore Shqiptare

Prill - Shtator 2020

Projekti "Strong Albanian Local Statistics" (Statistika të Forta Vendore Shqiptare, SALSTAT) është pjesë e projektit "Bashki të Forta" i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për një periudhë katërvjeçare. Puna e projektit "Bashki të Forta" përqendrohet në zhvillimin e qeverisë vendore dhe decentralizmin në Shqipëri.

Palët kryesore të interesit të projektit SALSTAT janë INSTAT-i, bashkitë, ministri të linjës dhe institucione qeveritare, veçanërisht ato të cilat janë përgjegjëse për të dhënat administrative / regjistrat. INSTAT-i është partneri kryesor i projektit SALSTAT. Ministrinë e linjës, si dhe bashkitë janë partnerë kryesor, pasi ato janë përdoruese dhe prodhuese të të dhënave statistikore vendore dhe rajonale.

- Pavarësisht situatës së vështirë të krijuar nga pandemia Covid-19, projekti SALSTAT ka ndërmarrë hapa pozitivë përpara, duke përfunduar me sukses veprimtaritë e planifikuara për 6-mujorin e parë.

## Përmbajtja:

- Puna përgatitore për Vjetarin Statistikor Rajonal 2020
- Trajnim online mbi statistikat e mbetjeve urbane
- Pajisjet e TI-së për zyrat rajonale të INSTAT-it
- Treguesit afatmesëm në nivel rajonal dhe vendor
- Regjistri Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave
- Trajtime për stafin e INSTAT-it

## Puna përgatitore për Vjetarin Statistikor Rajonal 2020

Puna për përgatitjen e botimit të Vjetarit Rajonal 2020 (planifikuar që të botohet në 20 Nëntor 2020) ka vijuar me tregues afatmesëm shtesë në nivel rajonal dhe vendor. Puna është realizuar në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Federale të Statistikave Zvicerane (ZFS).

Pjesë e kësaj pune kanë qenë mbledhjet online të ekspertit të ZFS-së, Z. Werner Haug, me stafin e INSTAT-it, me qëllim përditësimin dhe zgjerimin e treguesve statistikorë të disponueshëm sipas rajoneve dhe bashkive. Kapitulli "Profili i Bashkive" ka më shumë tregues statistikorë dhe gjetje të reja të rëndësishme. Vjetari gjithashtu do të ketë edhe më shumë harta tematike përgjatë kapitujve, me qëllim pasqyrimin e krahasimit ndërmjet rajoneve dhe bashkive. Ky është Vjetari i dytë Rajonal i përgatitur në bashkëpunim me ZFS-në, dhe INSTAT-i synon përmirësimin e këtij botimi vit pas viti.



## Trajnim online mbi statistikat e mbetjeve urbane

Në vitin 2020, INSTAT në bashkëpunim me projektin SALSTAT ka aplikuar për herë të parë metodën inovative CAWI (grumbullimi i të dhënave nëpërmjet web-it) për të dhënat mbi mbetjet urbane nga bashkitë, referuar vitit 2019.

Kjo metodë e re do të mundësojë prodhimin e disa indikatorëve të rinj të disagreguar në nivel qarku dhe afatmesëm në nivel bashkie.

Në qershor të vitit 2020, INSTAT-SALSTAT organizuan trajnime online me të gjitha bashkitë mbi anketën statistikore për mbetjet urbane, nëpërmjet një platforme komunikimi online "Microsoft Teams", të instaluar në zyrat rajonale statistikore të INSTAT-it. Mbledhja e të dhënave bazuar në internet është kryer në Korrik / Gusht 2020.

Gjatë këtij procesi:

- 61 bashki janë trajnuar për anketat rreth mbetjeve urbane
- Nga 61 bashkitë u grumbulluan të dhënat
- Hartimi i raportit të cilësisë
- Publikimi i rezultateve

Rezultatet e para statistikore rreth mbetjeve urbane janë botuar në faqen zyrtare të INSTAT – Statistikat e Mbetjeve Urbane: <http://www.instat.gov.al/al/temat/mjedisi-dhe-energjia/mjedisi/publikimet/2020/mbetjet-e-ngurta-urbane-2019/>

Për më tepër, disa tregues dhe të dhëna do të publikohen në Vjetarin Rajonal 2020.



## Trajnime për stafin e bashkive

Vlerësimi i modulit të parë të trajnimeve për bashkitë përfundoi në Maj 2020, por për shkak të situatës së Covid-19, u desh që trajnimet të shtyheshin. Më në fund, trajnimet u zhvilluan nga 21 Shtatori deri më 9 Tetor 2020. Grupi i parë i trajnimeve për bashkitë u përqendrua në modulet e mëposhtme:

- Njohuri mbi Statistikat Zyrtare dhe Sistemin Statistikor
- Cilësia Statistikore (Niveli Fillestar)
- Mbledhja e të Dhënave dhe Përpunimi Statistikor
- Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE)
- Excel
- Shpërndarja, komunikimi dhe botimi
- Integrimi Evropian

Trajnimet u zhvilluan në ambientet e INSTAT-it, në grupe të vogla, duke marrë të gjitha masat përkatëse në kuadër të Covid-19. Të gjithë pjesëmarrësit e ndoqën kursin me shumë interes dhe vlerësimi pozitiv i tyre tregoi rëndësinë e trajnimeve mbi statistikat për bashkitë. Gjatë kohës së zbatimit të projektit, SALSTAT-i ka në plan t'u ofrojë bashkive trajnime të vazhdueshme rreth statistikave zyrtare.



## Pajisjet e TI-së për zyrat rajonale të INSTAT-it

Projekti SALSTAT ka hedhur hapat e parë drejt modernizimit të zyrave statistikore rajonale. Modernizimi i infrastrukturës së këtyre zyrave është një element i rëndësishëm për përmirësimin dhe lehtësimin e mëtejshëm të koordinimit dhe bashkëpunimit statistikor midis bashkive / qarqeve dhe zyrave rajonale, si dhe me selinë e INSTAT-it.

Në Maj / Qershor, të 27 zyrat rajonale u pajisën me infrastrukturë të re të TI-së, ku përfshiheshin 38 kompjuterë, licenca për përdorimin e softuerëve dhe pajisjeve, si dhe 28 fotokopjuese. Infrastruktura e modernizuar lehtësoi edhe trajnimin online për statistikat mbi mbetjet urbane.



## Treguesit afatmesëm në nivel rajonal dhe vendor

SALSTAT-i së bashku me INSTAT-in vazhdojnë të ofrojnë të dhëna statistikore në nivel rajonal dhe vendor, duke përmirësuar treguesit kryesorë aktualë dhe duke ofruar tregues të rinj për një periudhë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Një referencë e rëndësishme e punës është paraqitja e vazhdueshme e treguesve shtesë për Vjetarin Statistikor Rajonal si botimi më i rëndësishëm i INSTAT-it për treguesit në nivel rajonal dhe vendor. Synohet pasurimi dhe zgjerimi i treguesve statistikore për rajonet dhe bashkitë.

INSTAT-i po harton edhe një Memorandum Mirëkuptimi (MM), i cili përmirëson dhe përforcon bashkëpunimin me bashkitë, kryesisht mbi të dhënat statistikore. Kështu, synohet formalizmi dhe përcaktimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet dy partnerëve, veçanërisht roli i bashkive si përdorues dhe ofrues të të dhënave statistikore zyrtare. Një element i rëndësishëm do të jetë aneksi i miratuar me treguesit afatmesëm të identifikuar dhe përditësuar kohët e fundit.

## Regjistri Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave

SALSTAT-i po kryen një vlerësim të hollësishëm për variablat ekzistuese dhe variablat shtesë që nevojiten për krijimin e një regjistri statistikor të ndërtesave dhe banesave nga të gjitha burimet e mundshme (për shembull Cens-i i ardhshëm, Regjistri i Gjendjes Civile, Regjistri për lejet e reja të ndërtimit nga Agjencia e Zhvillimit të Territorit, të dhënat e disponueshme në bashki, etj.). Në bazë të gjetjeve, do të hartohet një propozim për regjistrin statistikor të ndërtesave dhe banesave. Kjo punë është ende në vazhdim dhe rezultatet do të jenë gati në muajt e ardhshëm.

Situata e vështirë e Covid-19 po shkakton vonesa të kësaj veprimtarie dhe mund të ndikojë edhe në planin e mundshëm të zbatimit.



## Trajnime për stafin e INSTAT-it

Më 28 – 29 Shtator 2020 u organizua një workshop mbi strategjinë dhe planin vjetor 2020 – 2021 të INSTAT-it dhe Planin Vjetor të Veprimit 2020-2021 të projektit të SALSTAT-it. Ky workshop vjen si një risi në kuadër të përfshirjes së aktiviteteve të projektit në planin vjetor të institucionit.



### FALEMINDERIT NGA EKIPI I SALSTAT

**Menaxher projekti:**

Martin Teichgraeber, Zyra Federale Zvicerane e Statistikave

**Koordinatorët:**

Eralda Pushaj, Koordinatorë me Njësitë e Qeverisjes Qendrore

Edlira Çeliku, Koordinatorë për Çështjet Administrative dhe Financiare

Alketa Doçi, Koordinatorë për Regjistrat dhe të Dhënat Administrative

Instituti I Statistikave - Tiranë

Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017

Email: [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)

Nr. telefoni: +355 (4) 2233356 / 2233358